

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0168-A0001***Paditësi/Ankuesi***B I**, fshati M, Komuna e Gjilanit**Kundër:***E paditura***N.SH. KBI “Agrokultura”**, Gjilan, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2185, të datës 24 mars 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2185, i datës 24 mars 2022 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI004-0072 i datës 21 mars 2014.
3. Detyrohet e paditura, AKP që në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj paditësit shumën prej 354.00 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurë të likuidimit.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 31 mars 2014, paditësi kishte parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI004-0072 të datës 21 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit

për dëshmëpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 354.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit, përkatësisht nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar.

Në ankesë paditësi kishte theksuar se paraqitja e provave të mjaftueshme me rastin e paraqitjes së kërkesës së tij ka qenë legjitime dhe në kohë të duhur. I njëjti thekson se më herët nuk ka mundur të kërkoj paga nga ndërmarrja për faktin se ndërmarrja nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm që t'i paguaj këto paga. Andaj kishte propozuar që kërkesa e paditësit të aprovohet si e bazuar ashtu që gjykata të merr vendim të pranoj kërkesën e paditësit dhe shuma e kërkuar të deponohet në xhirollogarinë e tij. Ankesës i kishte bashkëngjitur: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 21 korrik 2006 si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit dhe atë të xhirollogarisë bankare.

Me datë 8 dhjetor 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë në të cilën theksohet se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2. të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, theksohet se kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Nuk ka asnjë provë përpara AL-së se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës së parashkrimit. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar, ndërsa të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Paditësi mbrojtjes i kishte bashkëngjitur kërkesën për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 18 gusht 2016.

Me datë 17 janar 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për AKP-në nga e cila kërkon që të bashkëngjisë listën e punëtorëve të N.SH “Agrokultura” me dëshmitë mbi pagat e tyre e të cilët ishin punëtor të regjistruar pranë N.SH-së me datën e privatizimit dhe nëse ankuesi ishte në listën e punëtorëve dhe eventualisht paga e tij pranë N.SH-së.

Me datë 25 janar 2022, AKP duke iu përgjigjur urdhrin të lartcekur të gjykatës e kishte bashkëngjitur si provë: vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit, regjistrin për të ardhurat personale nga data 1 janar 2006 deri më 30 qershor 2006, disa lista me specifikacion të pagave sipas reparteve për vitin 2006 dhe disa regjistra për punëtorët që nuk kanë llogari rrjedhëse.

Me datë 7 shkurt 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar që brenda afatit prej 7 ditëve të parashtrij të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën dhe një listë të provave duke përfshirë librezën e punës duke e njoftuar të njëjtin që në rast se nuk e përmbushë urdhrin, DHPGJS mund ta refuzoj ankesën.

Me datë 24 mars 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2185 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke vërtetuar kështu vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI004-0072 të datës 21 mars 2014. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se në rastin konkret njoftimi i Agjencisë nuk ishte dëshmi e mjaftueshme me të cilën ankuesi do të argumentonte se ishte i punësuar pranë N.SH-së deri në datën e privatizimit të saj. Edhe përkundër urdhrin të gjykatës me të cilin iu ofrua një mundësi që të ofronte prova, ndër të tjerash edhe me librezë të punës e të dëshmonte se ishte i punësuar pranë N.SH, ankuesi nuk e kishte përmbushur. Duke u bazuar në listën e punëtorëve të parashtruar nga AKP por të përpiluar nga ana e ndërmarrjes në fjalë tregohet se ankuesi nuk ishte punëtor i regjistruar i N.SH deri në datën e privatizimit të saj. Andaj, gjykata konsideron se ankuesi nga dëshmitë e parashtruara nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat.

Me datë 5 prill 2022, ankuesi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjyimit të shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-14-2185 të datës 24 mars 2022, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të anuloi Aktgjykimin e ankimuar dhe të njëjtin t'ia kthej në rigjykim shkallës së parë ose ta ndryshoj duke marrë aktgjykim të aprovoj ankesën e tij. Në ankesë theksohet se shkëlja e dispozitave ligjore konsiston në faktin se aktgjykimi i ankimuar është konfuz i pakuptueshëm apo më mirë të them i njëanshëm kur është i tillë atëherë përmban të meta të cilat bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm. Nga kjo del se aktgjykimi i ankimuar është mbështetur në tërësi në vendimin e AL-së dhe fare se ka marrë parasysh faktin se punëtori është dëmtuar nga ndërprerja e parakohshme e kontratës së punës. Fatkeqësisht gjykata nuk ka marrë parasysh fare faktet e ankuesit por vetëm ka shikuar afatin 3 vjeçar dhe nuk ka hyrë fare në interpretimin

e normave juridike që i parasheh ligji por ka vepruar identik sikur AL. Andaj, me plot besim në Kolegjin e Apelit kërkon që çështja të zgjidhet drejtë. Ankesës i kishte bashkëngjitur kopjen e librezës së punës së paditësit.

Me datë 20 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsvetimi ligjor:

Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI004-0072 i datës 21 mars 2014 dhe Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS, sa i përket kërkesës së paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 354.00 euro.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se Autoriteti i Likuidimit kishte vlerësuar se e njëjta është parashkruar.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur këto prova: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 21 korrik 2006 si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Shkalla e parë e DHPGJS-së pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar për faktin se kishte konsideruar se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë lidhur me kërkesën e tij përveç njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të cilin nuk e konsideronte si provë relevante

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së nuk kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar.

Paditësi gjithashtu edhe më shkallë të dytë i kishte bashkëngjitur ankesës së tij kopjen e librezës së punës me të cilën dëshmonte që të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 21 korrik 2006.

Kolegji i Apelit vlerëson se nga njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 21 korrik 2006, i dorëzuar si provë nga paditësi në ankesën e tij në shkallë të parë vërtetohet se i njëjti ka punuar në N.SH deri në ditën e privatizimit të saj pra me 21 korrik 2006, me ç' rast edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Gjithashtu edhe nga librezja e punës e paditësit e bashkëngjitur si provë në shkallë të dytë vërtetohet fakti se paditësi ka ofruar shërbime për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj me 21 korrik 2006, kur edhe i është mbyllur librezja e punës.

Andaj nga të lartcekurat Kolegji i Apelit vlerëson se paditësit duhet t'i njihet e drejta në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 354.00 euro, e cila shumë do t'i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurë të likuidimit.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar. .

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 janar 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
